

## LULZIM NIKA

### ROLI I DIPLOMACISË EVROPIANE PAS VITIT 1991 NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SË KOSOVËS

Diplomacia Evropiane ishte në pozitë dominuese pas humbjes së ndikimit sovjetik në shtetet e Evropës Lindore. Kriza Jugosllave ishte sfida e parë për Komunitetin Evropian, i cili nuk arriti të ndalonte konfliktin në hapësirat e ish Jugosllavisë. Diplomacia evropiane nuk u tregua e vendosur në qëndrimet fillestare të krizës jugosllave duke bërë përpjekje për të ruajtur Federatën Jugosllave, në një kohë kur kjo ishte e pamundur për shkak të ardhjes në pushtet të liderëve që kërkonin pavarësi nga Federata Jugosllave.

Përpjekjet e diplomatëve evropianë në Konferencën e Londrës, të Hagës dhe pastaj në vazhdim në atë të Gjenevës, nuk arritën që të ndalnin shtrirjen e konfliktit drejt Kosovës, aty ku paqja u vendos vetëm atëherë kur diplomacia u kombinua me forcën ajrore të NATO-s.

Kriza jugosllave, si dhe më pas shtrirja e krizës në Kosovë, paraqesin një rast të vështirë të shpërthimit të nacionalizmit etnik, i cili e vuri politikën evropiane të jashtme dhe të sigurisë, si asnjëherë më parë përballë sfidës së saj më të madhe në aplikimin e real politikës.<sup>1</sup>

Bashkësia ndërkombëtare e trajtoi qysh në një fazë të hershme çështjen e shpërbërjes së Jugosllavisë. Debati më i madh ishte nëse duhej të ndërhyhej në shpërbërjen e shtetit multietnik dhe nëse po në çfarë forme do të bëhej kjo. Evropianët fillimisht kishin bindjen se mund ta zgjidhin të vetëm sfidën në Ballkan: “Kjo është ora e Evropës. Nuk është ora e amerikanëve”, u shpreh ministri i Jashtëm i Luksemburgut, Zhak Pos, pas shpërthimit të luftimeve të para në territorin e atëhershëm të Jugosllavisë.<sup>2</sup> Në intervistën dhënë gazetës “Nepsabadshag”, ministri i Jashtëm hungarez, Geza Jazsenski, deklaronte: Shqipëria dhe Hungaria i

<sup>1</sup> Khs.: Stephen Iwan Griffiths, *Nationalism and Ethnic Conflict. Threats to European Security*, Oxford: 1993, f. 125.

<sup>2</sup> Zhak Pos, i cituar në Alan Ridding, “European Leaders Seek Common on Ceisis”, *Nju-Jork Tajms*, 29.06.1991, f. 4; cituar sipas Erica A. Witte, *Die Rolle der Vereinigten Staaten im Jugoslawien - Konflikt und der aussenpolitische Handlungsspielraum der Bundesrepublik Deutschland (1990-1996)*, München: 2000, f. 6.

kushtojnë shumë vëmendje problemit jugosllav, të dy vendet kanë pakica kombëtare në Jugosllavi. Në përkrahim politikën e Komunitetit Evropian për çështjen e Jugosllavisë.<sup>3</sup>

Dobësimi i kërcënimit sovjetik krijoi kushte që vendet evropiane-perëndimore të forconin pozitat e tyre në planin e politikës ndërkombëtare. Rasti i Jugosllavisë do t'i shërbente Bashkimit Evropian si një lloj testi i politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë si dhe do të afirmonte pozicionin e BE si forcë politike.<sup>4</sup> Këtë pozicion të evropianëve e miratoi edhe administrata amerikane dhe në këtë mënyrë evropianët u vunë para një sprove serioze, e cila do të dëshmonte nëse BE-ja ishte e aftë për të menaxhuar krizën në Jugosllavi.

Nëse BE do të dështonte, do të bëhej e domosdoshme nevoja imediate e angazhimit të SHBA-së në çështjet evropiane edhe pas përfundimit të konfrontimit ideologjik Lindje-Perëndim.

Në Konferencën e Hagës për Jugosllavinë më 1991<sup>5</sup> ku dhe u vulos shpërbërja e saj, Kosova, nuk u trajtua si pjesë konstituive e shtetit jugosllav, edhe pse dihej se abrogimi i njëanshëm i statusit të saj qe bërë më 23 mars 1989<sup>6</sup> nga Kuvendi i Serbisë. Ministri i Jashtëm austriak Alojz Mok, gjatë qëndrimit në Uashington, deklaroi para gazetarëve, më 7 nëntor 1991 se "problemi jugosllav do t'u lihet SHBA nëse nuk arrin ta zgjidhë Bashkimi Evropian."<sup>7</sup>

BE dhe shtetet e mëdha evropiane nuk e kuptuan drejt dhe në kohë rrezikun që vinte nga kriza në Jugosllavi. Studiuesi, Dyrk Scherff konstaton me të drejtë se "Potenciali i luftës në Jugosllavi që ishte nxitur nga nacionalizmi ra në vesh të shurdhër në BE sepse fluksi i informacioneve nuk do të depërtonte në BE, konkretisht nuk u perceptuan ato çfarë raportonin shërbimet informative. Për më tepër, ngjarjet e viteve

<sup>3</sup> Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ), Fondi Kosova, Viti 1990-1991, Dosja 1182, 1173, 1151, Kutia: 39.38. Qëndrimi i Hungarisë për çështjen shqiptare.

<sup>4</sup> Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Prishtinë: Koha, 2013, f. 119.

<sup>5</sup> Nga kjo konferencë doli edhe Komisioni i Banditerit, i cili Kosovën nuk e llogariti as si term gjeografik e lëre më si njëri nga tetë subjektet që kanë përbërë Federatën Jugosllave.

<sup>6</sup> Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar. Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë: Koha, 2011, f.93.

<sup>7</sup> AMPJ, Dosja, 1609, B.V11/2.

1990 u injoruan tërësisht, kur ishin bërë të dukshme shenjat e shpërbërjes së Jugosllavisë.”<sup>8</sup>

Por kishte paqartësi dhe ngurrim edhe në strukturat drejtuese të NATO-s. Në qershor të vitit 1991 komandanti i ushtarak i forcave të NATO-s në Evropë, gjenerali John Shalikashvilli deklaronte: “NATO nuk do të ndërhyjë në Jugosllavi, sepse ajo nuk është brenda zonës mbrojtëse të saj.”<sup>9</sup>

Në fillim evropianët ishin të papërgatitur si në pikëpamje politike ashtu dhe ushtarake për një konflikt të tillë. Studiuesi zviceran Urs Altermatt, në studimin e tij të titulluar “Etnonacionalizmi në Evropë”,<sup>10</sup> shkruante se lufta jugosllave e viteve 1991-1995 e gjeti diplomacinë evropiane krejtësisht të papërgatitur. Institucionet evropiane nuk ishin të afta t’i perceptonin rreziqet që vinin nga konfliktet nacionale në Ballkan dhe as t’i jepnin fund luftërave vrastare atje.

Ishte disi e pakuptueshme që evropianët ishin në gjendje të rregullonin përditshmërinë ekonomike, madje deri në detaje më të vogla, por ata po qëndronin duarkryq kur në kontinentin e tyre po kryheshin krime të tmerrshme, si në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe më pas edhe në Kosovë.<sup>11</sup>

Për arritjen e Marrëveshjes së Dejtonit dhe të Parisit<sup>12</sup> ndërhyrja amerikane u bë e pashmangshme. Me ndërmjetësimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe me përfshirjen e BE-së u bë i mundur nënshkrimi i Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit, më 14 dhjetor 1995, e

<sup>8</sup> Dyrk Scherff, “Die Fähigkeit der Europäischen Union zum aktiven Krisenmanagement: Lehren aus den Vermittlungsbemühungen 1991/1991 während des jugoslawischen Bürgerkrieges und der derzeitige Konflikt im Kosovo”, in *Südosteuropa* 7-8, Oldenbourg München: 1998, f. 299.

<sup>9</sup> D. Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova ...*, f. 120.

<sup>10</sup> Shih: Urs Altermatt, *Etnonacionalizmi në Evropë*, Tiranë: Phoenix, 2002.

<sup>11</sup> Jean-Yves Haine, “Eine historische Perspektive”, in Nicole Gnesotto (Hrsg.), *Die Sicherheits- und Verteidigungspolitik der EU*. Paris (EU Institute for Security Studies – EUISS): 2004, f. 41-63 (këtu f. 41).

<sup>12</sup> Në tetor 1995, presidentët e Serbisë, Bosnjës dhe Kroacisë pranuan të mblidhen në bazën ajrore të Wright-Patterson, Ohio të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të diskutuar dhënien fund të dhunës në Bosnjë-Hercegovinë. Marrëveshja u arrit më 21 nëntor 1995 dhe u nënshkrua zyrtarisht në Paris, më 14 dhjetor 1995. Kjo marrëveshje, që ndryshe njihet si Marrëveshja Dayton, u dha fund tre vjet e gjysmë luftës në Bosnjë.

cila i dha fund luftës afro katër vjeçare në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kroaci.<sup>13</sup>

Bashkimi Evropian dështoi në këto zhvillime, duke u shfaqur si një koncert i vajtueshëm impotent. BE e vështroi politikën e spastrimit etnik në ish-Jugosllavi, duke qëndruar pothuajse duarkryq. Në fillim të konfliktit dolën në skenë sërish, si të kishin qenë të kyçura në një burg të historisë, modelet e vjetra nacionaliste të Evropës: gjermanët morën në mbrojtje Kroacinë, francezët mbështetën serbët<sup>14</sup>, ndërsa shqiptarët vazhdonin të mos gëzonin përkrahjen e qendrave ndërkombëtare të vendosjes.

Nisur nga kjo, Bashkimi Evropian është akuzuar se dështoi për të vënë në agjendën e zgjidhjes çështjen e Kosovës, kur koha ishte pjekur për një gjë të tillë. Në konferencat kushtuar Jugosllavisë, që filluan në Hagë në vitin 1991 dhe mbaruan në Dejton më 1995, ky problem sërish u la mënjanë.<sup>15</sup>

Konferenca e Londrës që vijoi me diskutimet në Gjenevë (1992-1995)<sup>16</sup> e shqyrtoi çështjen shqiptare vetëm aq sa iu desh asaj për informacion burimor. Duke konstatuar këtë fakt dhe rreziqet që vinin nga përjashtimi i diskutimit të gjendjes së shqiptarëve, kongresmeni amerikan William H. Zeff, JR, i shkruante presidentit, Bush se “në situatën e rëndë ku në bazë të ekspertëve parashihet afrimi i luftës mes shqiptarëve dhe serbëve, ndër të tjera kërkohet edhe përfshirja e liderit të shqiptarëve të Kosovës Ibrahim Rugova në Konferencën e Londrës dhe mundësisht ai të pritët në një takim në Shtëpinë e Bardhë për t’u informuar rreth gjendjes në Kosovë”.<sup>17</sup>

<sup>13</sup> Për më tepër rreth zhvillimeve në Bosnjë e Hercegovinë, shih: Calic Marie-Janine, *Krieg und Frieden in Bosnien-Herzegovina, (Erweiterte Neuauflage)*, Frankfurt a.M.: 1996; dhe Wolfgang Petritsch, *Bosnien und Herzegovina 5 Jahren nach Dayton. Hat der Friede eine Chance?* Klagenfurt-Wien-Ljubljana-Tuzla-Sarajevo: 2001.

<sup>14</sup> Altermatt konstaton dobësinë e evropianoperëndimorëve karshi kursit nationalist në Ballkan, duke potencuar se paqja gjeopolitike u ble së bashku me ndarjen etnike.

<sup>15</sup> Khs.: Dazu außerdem: Jens Reuter: “Die internationale Gemeinschaft und der Krieg in Kosovo”, in *Südosteuropa: Jg. 47*, nr. 7-8, München: 1998, f. 281-297 (203).

<sup>16</sup> E. Philip & David Auerswald, *The Kosovo Conflict. A Diplomatic History Through Documents*, Kluwer Law International Cambridge / The Hague: 2000.

<sup>17</sup> William H. Zeff, JR 1<sup>st</sup> District, New Hampshire, Congress of the United States House of Representatives Washington, DC20515-1901, August 4, 1992; The White House, Washington, October 23, 1992.

Në përgjigjen zyrtare për brengosjen e kongresmenit Zeliff, Shtëpia e Bardhë ju përgjigj se “Konferenca e Londrës është organizuar për t’i treguar të gjithë aktorëve të përfshirë në konfliktin jugosllav vendosmërinë tonë dhe të partnerëve, që nuk do të lejojmë përshkallëzimin e dhunës në Kosovë”.<sup>18</sup>

Vendimet e Konferencës së Londrës nuk sollën ndonjë përparim drejt dialogut në hapësirën e Jugosllavisë, ndërsa në Kosovë gjendja shkonte drejt përkeqësimit dhe rritjes së brutalitetit të pushtuesit jugosllav.<sup>19</sup> Këtë e përshkruanin edhe raportet e organizatave ndërkombëtare dhe shtypi i kohës që raportonin për një gjendje të rëndë dhe diskriminim të popullsisë shqiptare në Kosovë. Për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe për mohimin e arsimit në objektet shkollore, raportonin si shtypi i kohës, Komiteti i Helsinkit Për të Drejtat e Njeriut dhe Amnesty Internacional ne raportet mujore dhe vjetore të tyre.

“Shqiptarët e pritën me zhgënjim të hidhur rolin që u ishte caktuar në Londër.”<sup>20</sup> Kosova mori pjesë në Konferencë me atë që u njoh si “dhoma-jehonë”, por pa ndonjë angazhim thelbësor për çështjen e saj. Kjo kishte për qëllim që më vonë të bartet si problem minoritar në Konferencën e Gjenevës.

Megjithatë, vigjilenca amerikane dhe vendosmëria e tyre për të mos lejuar spastrimin etnik në Kosovë erdhi si një ngushëllim i madh në këtë kohë. Në dhjetor 1992, në të famshmin “Paralajmërim të Kërshëndellave” Presidenti Bush e informoi Millosheviçin se agresioni ne Kosovë nuk do të lejohej.<sup>21</sup> Këtë paralajmërim administrata e Presidentit Clinton e përsëriti në disa raste gjatë vitit 1998.<sup>22</sup>

Qasja e BE-së ndaj Millosheviçit ishte e dominuar për shumë vite nga përpjekjet për të arritur koncesione përmes hapave të vegjël duke u bazuar në kushtetutën e vitit 1974. Nisur nga kjo, shtetet evropiane nuk e

---

<sup>18</sup> *Memo for Arnold Kanter – state, Paul Wolfowitz – OSD, Barry McCaffery – JCS, on Presidential Messages on Kosovo*, November 18 1992, National Security Council, Washington DC 20506.

<sup>19</sup> Jane Holl Files – Electronic Files Electronic Messages – Kosovo [1] [OA/ID CFO1566] Kosovo[2][OA/ID CFO1566] Kosovo [3] [OA/ID CFO1566] Kosovo [4] [OA /ID CFO1566] Electronic Messages - Kosovo [OA/ ID CF 01746] London Conference [1], [2], [3]. Jane Holl Files –Subject Files Balkans [OA/ ID CFO1747]

<sup>20</sup> Wolfgang Petritsch, Robert Pihler, *Rruga e gjatë në luftë ...*, f. 78

<sup>21</sup> *Memo for Arnold Kanter – state, Paul Wolfowitz – OSD, Barry McCaffery – JCS ...*

<sup>22</sup> D. Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova ...*, f. 131.

mbështetën kërkesën e shqiptarëve për shkëputje dhe pavarësi të Kosovës.

Ndryshimi i situatës në Jugosllavi, luftërat e Serbisë në rajon, politika represive ndaj shqiptarëve<sup>23</sup> nuk lanë shumë hapësirë për të shpresuar se çështja e Kosovës mund të adresohet me mjete paqësore. Edhe kursi paqësor i shqiptarëve nuk tërhoqi shumë vëmendjen e shteteve evropiane dhe nuk krijoi tek ata bindjen se Kosova përbënte një problem të pazgjidhur. Veç tjerash, BE-ja nuk dëshironte të hapte edhe një front të ri, e të merrej me çështjen e Kosovës.

Gjithashtu në këtë kohë çështja e Kosovës dhe rreziku i situatës atje u zbeh nga konfliktet e përgjakshme në Kroaci dhe Bosnje. Kjo vihej re në publik dhe në perceptimin politik, edhe pse situata në Kosovë u vlerësua nga Parlamenti Evropian si shumë shpërthyes qysh në vitin 1990 dhe u shfaq frika se ajo mund të çonte në një luftë të armatosur.<sup>24</sup>

Në këtë linjë, Këshilli i Evropës, në Deklaratën e Lisbonës (qershor 1992), shprehte përkrahjen për procesin e konsolidimit të institucioneve demokratike si dhe për “përpjekjet legjitime të banorëve të Kosovës për autonomi”, e cila duhej të trajtohej brenda kornizës së Konferencës së Paqes për ish-Jugosllavinë.<sup>25</sup> Po ashtu, në këtë deklaratë theksohej mosnjohja e të drejtës së shtetësisë së vendeve të dala nëpërmjet luftës, përkatësisht synimet për pavarësi në Evropën Juglindore për entitetet që nuk kishin statusin e republikës.<sup>26</sup> Edhe në Deklaratën e Edinburgut

<sup>23</sup> Amnesty Internacional, AI Index: EUR 48/18/92, Yugoslavia Ethnic Albanians – Victims of torture and ill-treatment by police in Kosovo province, Jun 1992.

<sup>24</sup> Entschließung der Europäischen Parlament zum Kosovo, vom 11. Oktober 1990, Amtsblatt, Nr. C 284/129, Abs. G.

<sup>25</sup> Shih: “Europa Rat, Schlussfolgerung der Tagung des Europäische Rates der Staats- und Regierungschefs am 26-27. Juni 199 in Lissabon; Bericht der Aussenminister zur GASP, in: Borkenhagen, f. 228.

<sup>26</sup> Statusin e Republikës, i cili për evropianët u bë parim përcaktues për njohjen e shtetësisë, e gëzonin vetëm kombet sllave, kurse kombësive (shqiptarëve) nuk u njihej një e drejtë e tillë, pasi në këtë mënyrë do të pranohej statusi i kombit të ndarë. Për më tepër, mosnjohja e të drejtës së secesionit në qarqet evropiane në këtë kohë justifikohet me frikën se krijimi i shteteve të reja në territorin e Jugosllavisë mund të përbënte precedent për ambiciet nacionaliste të popujve sovjetikë. Pra, për shkak të arsyeve politike dhe të sigurisë dëshirohej të shmangej një “ballkanizim” i procesit të shpërbërjes së Perandorisë Sovjetike. Në këtë mënyrë injorohej fakti që shqiptarët qysh atëherë përbënin popullin e tretë në kuadrin e ish-Jugosllavisë. Megjithatë, me Kushtetutën e vitit 1974, fituan vetadministrim të gjerë dhe me këtë, *de facto* – por jo

(dhjetor 1992) BE nënvizonte, domosdoshmërinë e rikthimit të "autonomisë së Kosovës në kuadër të Serbisë".<sup>27</sup>

Përpjekjet e Bashkimit Evropian në këtë periudhë ishin të drejtuara kryesisht në parandalimin e dhunës dhe shpërthimin e luftës në Kosovë. Këto përpjekje pas vitit 1992 kishin si qëllim që të pengonin përdorimin e dhunës dhe shpërthimin e veprimeve armiqësore në Kosovë. Politika paqësore e shpallur nga Ibrahim Rugova dhe shteti i Kosovës në hije që u krijua nën udhëheqjen e tij, gjetën kudo në botën perëndimore mbështetje morale. Rugova u përpoq me këmbëngulje për të ndërkombëtarizuar problemin e Kosovës.

Përvoja e mëvonshme tregoi se politika e jashtme evropiane ndaj Jugosllavisë, në periudhën 1990-1996 vuante nga mungesa e vullnetit dhe nga dobësia e rolit udhëheqës, të cilin nuk arriti ta luante as Gjermania dhe as ndonjë shtet tjetër evropian. Ky rol i kufizuar i evropianëve, do të ndryshonte gradualisht në periudhën e luftës së Kosovës 1997-1999, duke mbështetur në kuadrin e NATO-s ndërhyrjen ushtarake. Por, roli vendimtar ishte i SHBA çka bëri që BE të humbiste disi prestigjin dhe besueshmërinë ndërkombëtare si forcë kryesore dhe autoritare për zgjidhjen e krizës.<sup>28</sup> Si në rastin e Bosnjës, ashtu edhe në luftën Kosovës, evropianët ishin të detyruar të shikonin se si amerikanët, para dyerve të tyre, po luanin një rol predominues në drejtimin e negociatave dhe në menaxhimin e krizës. Kështu, iniciativat në fushën e menaxhimit të krizave kaluan nga BE-ja tek OKB-ja, dhe më pas te SHBA-ja. Në këtë fazë nismat evropiane, të cilat nga 1 nëntori i vitit 1993 i ndërmori Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë, u limituan në rrafshin humanitar. Veçanërisht roli jetik i SHBA-së në luftën e Kosovës çoi në riorientimin e marrëdhënieve euroatlantike dhe ishte nxitje për angazhimin e BE, konkretisht për riorientimin e saj në planin e politikës së jashtme. Mirëpo edhe pas kësaj, Bashkimi Evropian nuk qe në gjendje

---

*de jure*, u bënë gati të barabartë me njësitë e tjera republikane. Për më tepër, shih: Fee Rauert, Kosovo, f. 196-197.

<sup>27</sup> Stefan Troebst, *Conflict in Kosovo: failure of prevention? An analytical documentation, 1992-1998*, Flensburg, 1998 (ECMI Working Papers, 1, maj 1998), f.49.

<sup>28</sup> Kancelaritë kryesore evropiane ecnin nëpër rrugët e tyre të veçanta nacionale, pa arritur dot një veprim të përbashkët. Në procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, Gjermania u akuzua nga kritikët për qëndrim të njëanshëm proslloven dhe prokroat, ndërsa politika zyrtare e Britanisë së Madhe dhe e Francës u paraqit si proserbe nga mediet ndërkombëtare, veçanërisht gjatë luftës në Bosnjë e Hercegovinë.

të përpunonte dhe të zhvillonte një strategji dhe politikë të përbashkët të jashtme dhe as të fliste me një zë lidhur me problemin e Kosovës.

Shtetet e BE, pas Konferencës së Dejtonit, ranë në ujdë për normalizimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë e mbetur, pas gjoja, përmirësimit thelbësor të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Si rrjedhim i këtij diskursi, në fillim të vitit 1996, Franca nxitoi të njihje Jugosllavinë e Millosheviçit,<sup>29</sup> hap të cilin shumë shpejt e ndoqën edhe vendet e tjera anëtare të BE.<sup>30</sup> Kjo dëshmoi përsëri se Bashkimi Evropian ishte i paafhtë për të bashkërenduar politikën e tij ndaj Beogradit dhe të kryente hapin e njohjes nën kushtet e caktuara bashkërisht. Parlamenti Evropian, duke iu referuar shkeljeve të vijueshme të të drejtave të njeriut në Kosovë, kritikoi anëtarët që e kishin njohur Beogradin. Po kështu, ishte e pamjaftueshme thirrja që Këshilli Evropian në prill 1996 i drejtoi Beogradit për t'i njohur Kosovës “një masë të lartë autonomie”. Ky ishte një qëndrim aspak inkurajues për Kosovën, pasi kjo konfirmonte pozicionin se Bashkimi Evropian ishte kundër ndryshimit të *status quo*-së territoriale dhe riaktualizoi idetë e vjetra të “dialogut” dhe të “masave që krijojnë besim”.<sup>31</sup> Kjo ishte një strategji që nuk mund të sillte ndonjë përparim drejt zgjidhjes së problemit të Kosovës.

<sup>29</sup> E ashtuquajtura Jugosllavi e Tretë (1992-2003) u krijua në mes Serbisë dhe Malit të Zi dhe ishte pretendim i Millosheviçit për të trashëguar krijesën paraprake shtetërore. Në literaturën e huaj prej vitesh përdoret emërtimi Jugosllavi e mbetur për Republikën Federative të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi), së cilës iu mohua pretendimi për të trashëguar vazhdimësinë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, e cila, nga nëntori i vitit 1991, edhe zyrtarisht u pranua se hyri në procesin e shpërbërjes. Komisioni i Badinterit vlerësoi se, me shpërbërjen e Jugosllavisë, kishte përfunduar edhe subjektiviteti juridiko-ndërkombëtar i atij shteti që nga korriku i vitit 1992. Ndërsa, në vitin 2003, këto dy vende hoqën emrin e Jugosllavisë, krijuan Unionin Serbi-Mali i Zi dhe, në bazë të marrëveshjes, thuhet se, në momentin e ndarjes së tij, të gjitha detyrimet e Jugosllavisë së mbetur (Serbi-Mali i Zi), duke përfshirë edhe Rezolutën 1244, do t'i kalojnë Serbisë. Unioni Serbi-Mali i Zi, që është konsideruar produkt i Javier Solanës dhe shpeshherë është quajtur me ironi “Solania”, mori fund në maj të vitit 2006. Me këtë, Kosova mbeti çështja e fundit e pazgjidhur në Ballkan dhe nën protektoratin ndërkombëtar të OKB-së, i cili *de jure* ka mbetur në fuqi edhe pas deklarimit të Pavarësisë në vitin 2008, ngaqë Rusia është kundër ndryshimit të Rezolutës 1244.

<sup>30</sup> Sabrina P. Ramet, “Die politische Strategie der Vereinigten Staaten in der Kosovo-Krise – Parteipolitik und nationales Interesse”, aus: Reuter/Clewing: *Der Kosovo Konflikt...*, f. 369.

<sup>31</sup> Stefan Troebst, *Conflict in Kosovo...*, f. 49.

Ndryshe nga shtetet e Bashkimit Evropian, ShBA nuk e njohu RF të Jugosllavisë, nuk kishte ambasada të ShBA në Beograd dhe Uashingtoni e quante këtë shtet me emërtimin “Serbi e Mali i Zi”. Për shkak të Kosovës, Uashingtoni, me ndihmën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ngriti të ashtuquajturin “mur të jashtëm” të sanksioneve kundër Jugosllavisë së mbetur.

Në këto rrethana filloi ndërgjegjësimi politik i shqiptarëve të Kosovës dhe para lëvizjes kombëtare shtet-formuese u shtrua nevoja e rishikimit të pozicionit të saj politik, konkretisht u nënvizua domosdoshmëria e formimit të organizmave të reja politiko-ushtarake. Si rrjedhim i cenimit permanent të të drejtave të shqiptarëve dhe përkeqësimit të situatës socio-ekonomike, më 1996 shfaqet Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK),<sup>32</sup> e cila jo vetëm që ndikoi për t'i dhënë fund *status quo-së* së pafavorshme për shqiptarët, por përshpejtoi edhe përfshirjen ushtarake të NATO-s, në këtë kontekst edhe të shteteve anëtare të BE-së për gjetjen e një zgjidhjeje për problemin e Kosovës.

Para kësaj, ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, siç ishte për shembull, iniciativa Kinkel –Vedrin e vjeshtës së vitit 1997,<sup>33</sup> ishte fokusuar në kontekstin e përmirësimit të *status quo-së* në pikat e autonomisë, të të drejtave njerëzore dhe të të drejtave të pakicave<sup>34</sup>. Megjithëse kjo përjashtonte *a priori* opsionin e krijimit të një shteti të pavarur të Kosovës, Beogradi e konsideronte këtë si një “përzierje në punët e brendshme”.

Politika e qeverive të shteteve anëtare të BE-së në raport me Kosovën për një kohë të gjatë luajti një rol dytësor. Ky pozicion i tërhequr ishte një nga faktorët kryesorë që diktoi riaktivizimin e Grupit të Kontaktit për Ballkanin, që përbëhej nga SHBA, Britania e Madhe, Franca, Italia, Gjermania dhe Rusia, i cili në shtator të vitit 1997 mori në shqyrtim problemin e Kosovës<sup>35</sup>.

<sup>32</sup> J. Reuter, “Die internationale Gemeinschaft und das Kosovo-Problem 1991-1997 ...”; Stephan Lipsius, “Untergrundorganisationen im Kosovo - Ein Überblick”, in *Südoesteuropa*, 1-2, München: 1998, f. 75-82.

<sup>33</sup> *Gazeta Bujku*, shtator, Prishtinë, 1997.

<sup>34</sup> *Po aty*.

<sup>35</sup> Grupi i Kontaktit është themeluar zyrtarisht në prill të vitit 1994, si Grupi i Kontaktit për Bosnjë- Hercegovinën. Në fillim Grupin e Kontaktit e përbënin ministrat e Punëve të Jashtme të Francës, Gjermanisë, Federatës Ruse, SHBA-së dhe Britanisë së Madhe. Në maj, pas këmbënguljes së madhe të Italisë, Grupi i Kontaktit u zgjerua edhe me

Në frymën e deklaratave të mëparshme të BE edhe Grupi i Kontaktit i bëri thirrje për dialog shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë. Ky pozicion pragmatist u saktësua më tej në Deklaratën e Moskës të shtatorit të vitit 1997. Sipas Grupit të Kontaktit, nuk ishte e pranueshme as *status quo*-ja e dhunshme dhe as kërkesa e palës shqiptare për pavarësi shtetërore të Kosovës. Në një përpjekje të sforcuar për maturi dhe drejtpeshim, në Deklaratën e Londrës të 9 marsit të vitit 1998, Grupi i Kontaktit dënoi si sjelljen brutale të forcave të sigurimit serb në Kosovë, po ashtu dhe veprimet ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian këmbënguli për sanksione të tjera kundër Beogradit, duke injoruar kështu përvojën e viteve të mëparshme se sanksionet plotësuese nuk do të kishin ndikim tek regjimi i Millosheviçit. Bllokimi i kredive dhe i borxheve të jashtme, ndalimi i investimeve në Jugosllavinë e mbetur dhe ndalimi i fluturimeve nga shoqëria ajrore JAT nuk patën asnjë efekt. Sanksionet, funksionuan sa për të treguar se Bashkimi Evropian nuk po qëndronte indiferent.

Meqë dhuna dhe terrori në Kosovë edhe gjatë vitit 1998 vijonin e nuk po dukej kurrfarë gatishmërie për pajtim, në tetor të vitit 1998, Richard Holbrook, nën kërcënimin e ndërhyrjes së NATO-s, detyroi Millosheviçin të pranonte dërgimin në Kosovë të 2000 vëzhguesve të paarmatosur të OSBE-së.<sup>36</sup> Njëkohësisht marrëveshja Hollbrook-Millosheviç parashikonte që aeroplanë zbulimi të NATO-s të fluturonin mbi Kosovë në kuadrin e operacionit “Eagle’s Eye” (“Syri i Shqiponjës”).<sup>37</sup>

Pas kësaj ndërmarrjeje, diplomacia evropiane, në suazat e Grupit të Kontaktit, vendosi që në muajin shkurt 1999 të ballafaqonte në Konferencën e Paqes në Rambuje përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës dhe të Serbisë, për të gjetur një zgjidhje për Kosovën.<sup>38</sup> Takimi në Rambuje duhej të orientohej sipas modelit të Konferencës së Dejtonit, që i kishte dhënë fund luftës në Bosnje.<sup>39</sup>

Italinë. Që nga vjeshta e vitit 1997 Grupi i Kontaktit filloi të veprojë si organ qendror koordinues për zgjedhjen e Krizës së Kosovës.

<sup>36</sup> Christopher R. Hill, *Outpost Life on the Frontlines of American Diplomacy*, Simon & Schuster, New York Edition October: 2014, p. 131-132.

<sup>37</sup> Marie-Janine Calic, “Die Jugoslawienpolitik des Westens seit Dayton”, *Aus Politik und Zeitgeschichte*, B34/99, 20 gusht 1999, f.22-23.

<sup>38</sup> Më 22 janar Grupi i Kontaktit u mblodh në Londër për të caktuar bazat për Konferencën e Paqes në Rambuje të Francës.

<sup>39</sup> Sylë Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi*, Prishtinë: Rilindja, 2001, f.76-80

Baza e bisedimeve ishte plani i paqes, nga i cili vetëm 20% mund të konsiderohej si material që mund të diskutohej. I parë në tërësi, bilanci i Konferencës së Rambujesë nuk mund të thuhet se ishte pozitiv. Për shtatëmbëdhjetë ditë rresht u zhvilluan bisedime, ku delegacionet folën vetëm me ndërmjetës, dhe jo me njëri-tjetrin.

Koncepti i Konferencës, së organizuar nga BE dhe vendet e tjera të Grupit të Kontaktit qëndronte në faktin se zgjidhja kërkohej vetëm në kuadrin e një autonomie në kuadër të Jugosllavisë së mbetur<sup>40</sup>, e cila ishte në kundërshtim me synimin e shqiptarëve për pavarësi. Por, meqë lihej e hapur mundësia e marrjes së vendimit përfundimtar mbi statusin e Kosovës, që në Rambuje ishte parashikuar për tre vjet, dhe Kosova mund të bëhej shtet, Beogradi refuzoi marrëveshjen. Në një situatë të tillë në të cilën lufta mbetej opsioni i vetëm, pasi Kosova kishte pranuar marrëveshjen, partnerët evropianë të NATO-s, megjithëse fillimisht nuk kishin bërë llogari zhvillimin e një lufte ajrore, u solidarizuan me sulmet ajrore kundër caqeve ushtarake serbe. Në fakt, pjesëmarrja e BE-së në sulmet ajrore, të cilat erdhën si pasojë e mungesës së një zgjidhjeje politike<sup>41</sup>, u debatua më herët në qarqet politike të shteteve anëtare, por kjo kërkohej të jetësohej nën mandatin e OKB-së. Kjo determinohej nga qëndrimi refuzues i Francës dhe i Italisë, të cilat kërkonin që çdo ndërhyrje ta kalonin përmes mandatit të OKB-së. Mirëpo, për të ruajtur unitetin e Aleancës Veriatlantike dhe për të mos vënë në lojë raportet midis Evropës dhe SHBA-së, shtetet evropiane nuk u tërhoqën në veprime të njëanshme, por iu bashkëngjitën operacioneve ajrore të NATO-s, duke marrë rol aktiv në gjetjen e një zgjidhjeje politike edhe gjatë rrjedhës së luftës. Ky qëndrim i politikës evropiane, përkundër kapaciteteve të kufizuara ushtarake, si dhe orvatja e vazhdueshme që në bord të futej edhe Rusia, i hapi rrugë iniciativës G-8 dhe, më pas, hartimit të një plani paqësor nga BE-ja, të cilin do ta pranonte dhe Sllobodan Millosheviç.

Ndryshimi fundamental i politikës së jashtme të BE-së, heqja dorë nga qasja e rezervuar lidhur me intervenimin ushtarak, dhe interesi i Millosheviçit për të nënshkruar më në fund planin e paqes në mungesë të një rrugëdaljeje tjetër, rezultuan në përfundimin e luftës së Kosovës

<sup>40</sup> Ch. R. Hill, *Outpost Life on the Frontlines of American Diplomacy ...*, p. 148.

<sup>41</sup> *Po aty*.

përmes Rezolutës 1244<sup>42</sup> të Këshillit të Sigurimit, nënshkrimit të Marrëveshjes Ushtarako-Teknike të Kumanovës (qershor 1999)<sup>43</sup> dhe më pas me marshimin e trupave të KFOR-it në Kosovë. Pa dyshim implementimi i “Planit Fisher”, që u bë pjesë e agjendës diplomatike të BE-së, ishte me rëndësi vendimtare për nxjerrjen e Kosovës jashtë kontrollit administrativ dhe ushtarak të Beogradit, gjë e cila nuk do të mund të arrihej pa një intervenim ushtarak të NATO-s, i pari në historinë e aleancës që u ndërmor ndaj një shteti sovran.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë krijoi shumë shpresa për triumfin e një rendi të ri botëror të arsyes dhe të së drejtës me aleancën veriatlantike në qendër të tij. Lidhur me këtë Rudolf Scharping shkruan: *“Një baraspeshë e re midis principeve të së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht të sovranitetit shtetëror dhe konsideratës ndaj të drejtave universale të njeriut, duhej të shqyrtohej. Konflikti për Kosovën, ndërhyrja kundër vrasjes së popullit dhe krimit më të rëndë kundër njerëzimit le të shpresojmë se është edhe fillimi i një procesi të tillë ndërkombëtar i të mësuarit”*.<sup>44</sup>

Sfidat e Evropës dhe Botës ende mbeten madhore dhe zhvillimet e paparashikueshme, por gjithsesi një precedent historik pozitiv tashmë u krijua. Evropa, pavarësisht sjelljes jo tërësisht adekuate në fazat e ndryshme të konfliktit shqiptaro-serb, më në fund u fut në hullinë e arsyes historike. Koha do të provojë nëse ky ishte një zhvillim rastësor apo standard i ri në politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë.

<sup>42</sup> Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit u miratua më 10 qershor 1999, pas marrëveshjes për tërheqjen e trupave serbe nga Kosova. Kjo rezolutë e përcakton statusin politik të Kosovës si protektorat të OKB-së, dhe i jep administrimin e Kosovës po kësaj organizate ndërkombëtare. Sipas kësaj rezolute, OKB ka përgjegjësinë për administratën civile, kurse NATO për sigurinë në Kosovë. Edhe pse rezoluta e bën Kosovën protektorat të OKB-së, në këtë rezolutë disa herë përmendet se Kosova është pjesë e Jugosllavisë.

<sup>43</sup> Enver Sopjani, *Përmbledhje aktesh ndërkombëtare për Kosovën 1999-2004*, Prishtinë: 2005, f. 101-107.

<sup>44</sup> Rudolf Scharping 2001, *Wir dürfen nicht wegsehen. Der Kosovo-Krieg und Europa*, Berlin: 1999, f. 222-223.

## Burimet dhe Literatura

### Fondet arkivore:

*Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (AMPJ).*

- Fondet Kosova, Dosja nr : 1182,1173,1151 vitit 1990-91, Kutia: 39.38.
- Fondi Kosova, Dosja nr. 1609, B V11/2, Titulli I materialit, Rrethë situatës ne Kosovë vitin 1991, Tiranë.
- Fondi Kosova, Dosja, nr. 1583, B V11- 2 DH, Titulli i materialit, Për qëndrimin e Gjermanisë ndaj Kosovës, vitin 1991, Tiranë.
- Fondi Kosova, Dosja, nr 1148, Titulli i materialit informacione, radiograme nga Ambasada jonë ne Vjen mbi gjendjen ne Kosovë, 12-01-90-02-11-1990, Tiranë.

George H.W. Bush Presidential Library, College Station, TX, USA.

Blair Dominey Files – Subject Files Yugoslavia [OA/ID CF00232].

DCI Interagency Balkan Task Force [3] [OA/ID CFO174] Kosovo [OA/ID CFO1747].

Fondi Bush Presidential Records Staff and Office Files, National Security Council  
Craig Chellis Files – Subject Files (41) CSCE [ Conference on Security and Cooperation in Europe] – Yugoslavia Crisis [OA/ ID CFO1441].

Jane Holl Files – Electronic Files Electronic Messages – Kosovo [1] [OA/ID CFO1566] Kosovo [2] [OA/ID CFO1566] Kosovo [3] [OA/ID CFO1566] Kosovo [4] [OA /ID CFO1566] Electronic Messages - Kosovo [OA/ ID CF 01746] London Conference [1], [2], [3]. Jane Holl Files –Subject Files Balkans [OA/ ID CFO1747].

William J. Clinton, Presidential Library, and Museu, Fondi Kosovo FOIA2006-1186-F, 1997, Departament State Brifing Kosovo, 11,01

### Literatura:

ALERMATT, Urs - *Etnonacionalizmi në Evropë*, Tiranë: Phoenix, 2002.

BUXHOVI, Jusuf - *Kosova nga Konferenca e Londrës deri të protektorati ndërkombëtar*, Prishtinë: Faik Konica, 2012.

CALIC, Marie-Janine - *Krieg und Frieden in Bosnien-Herzegovina, (Erweiterte Neuausgabe)*, Frankfurt a.M., 1996;

Dazu außerdem: Jens Reuter: “Die internationale Gemeinschaft und der Krieg in Kosovo”, in *Südosteuropa: Jg. 47*, nr. 7-8, München: 1998.

DEMI, Leonard - *Shqipëria dhe diplomacia amerikane*, Tiranë: Onufri, 2000.

DI LELLIE, Anna - *The case for Kosova*, Anthem Press, London & New York: 2006.

DYRK, Scherff - Die Fähigkeit der Europäischen Union zum aktiven Krisenmanagement: Lehren aus den Vermittlungsbemühungen 1991/1991

- während des jugoslawischen Bürgerkrieges und der derzeitige Konflikt im Kosovo, in: *Südosteuropa* 7-8, München, 1998.
- E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, grup autorësh, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë & Instituti i Historisë, Tiranë: 1990.
- E vërteta mbi Kosovën*, Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Shtëpia e Botimeve Enciklopedike, 1993.
- Entschließung der Europäischen Parlament zum Kosovo, vom 11. Oktober 1990, Amtsblatt
- Europa Rat, Schlussfolgerung der Tagung des Europäische Rates der Staats- und Regierungschefs am 26-27. Juni 199 in Lissabon; Bericht der Aussenminister zur GASP, In: Borkenhagen
- FISCHER, Joschka - *Vitet kuq-gjelbër*, Prishtinë: Koha, 2008.
- GECAJ, Bajram - *Konferenca e Rambujesë*, Prishtinë: AIKD, 2009.
- GLENNY, Misha - *Historia e Ballkanit, 1804-1999*, Tiranë: Toena, 2007.
- GRIFFITHS, Stephen Iwan - *Nationalism and Ethnic Conflict. Threats to European Security*, Oxford: 1993.
- HAINÉ, Jean-Yves - "Eine historische Perspektive", in Nicole Gnesotto (Hrsg.), *Die Sicherheits- und Verteidigungspolitik der EU*. Paris (EU Institute for Security Studies – EUISS): 2004.
- HILL, Christopher R. - *Outpost Life on the Frontlines of American Diplomacy*, Simon & Schuster, New York Edition October: 2014.
- HOWARD, Clark - *Civil Resistance in Kosovo*, Pluto Press, 2000.
- LIPSIUS, Stephan - "Untergrundorganisationen im Kosovo - Ein Überblick" in *Südosteuropa*, 1-2, München, 1998.
- PETRITSCH, Wolfgang - *Bosnien und Herzegovina 5 Jahren nach Dayton. Hat der Friede eine Chance?* Klagenfurt-Wien-Ljubljana-Tuzla-Sarajevo, 2001.
- REUTER, Jens - Die internationale Gemeinschaft und das Kosovo-Problem 1991-1997;
- RIDING, Alan – "European Leaders Seek Common on Ceasis“, *Nju-Jork Tajms*, 29.06.1991.
- Rudolf Scharping 2001: Wir dürfen nicht wegsehen. Der Kosovo-Krieg und Europa, Berlin 1999.
- TROEBST, Stefan - *Conflict in Kosovo: failure of prevention? An analytical documentation, 1992-1998*, Flensburg, 1998 (ECMI Working Papers, 1, maj 1998).
- WITTE, A. - *Die Rolle der Vereinigten Staaten im Jugoslawien - Konflikt und der aussenpolitische Handlungsspielraum der Bundesrepublik Deutschland (1990-1996)*, München: 2000.